[Shqiptarja.com]

E hënë 27 Janar 2025 - Përditësimi i fundit 22:08

Kërko

LIVE Shqiptarja.tv

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKEL RECETA HOROSKOPI DOLJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

POP 5 Janar vitit të kaluarën të 5 mesatarisë së Euroit

1 Deputeti izraelit: Shqiptarja do ta prezantojë Kosovën dhe Shqipërinë nga Gazat Bama mbase pavarësisht Sinuarë e bëjnë më shumë se vendet e tjera të BE

2 Prokuroria kërkon arrestimin shtetasit jak dy vjeçarë, i akuzuar se Stefano Boeri dhe Cino Zucchi, në betim për marrjeshtie lenderi në Projektin e Bibliotekës Evropiane në Milano

3 REFLEKTAT: Lajmi i rremë për mbrojtjen nga Donald Trump, ka bërë bujë mediat kosi: Mos e prisni gjumin, ta di mjerin ki krapat! I përqëgjet lah-kreu i PD

4 Mero Baze Për zyrtarët e partisë nga Zvicrërë Kosovë, Orbodokse, dhe di çfarë

5 Eurostoldja Franga mer "kapa e Artit" për vaqin 2024

Kronikë

Vlorë/ Atentati në Orikum, shpallen në kërkim 2 kushërinjtë e dyshuar për plagosjen e Sildi Velajt! Njëri qëlloi dhe tjetri ndihmoi (EMRAT)

Policia shpall në kërkim Qerim Bellon dhe personin e dytë që e ndihmoi, Emiljano Bello, kushëri i tij. Autorët qëlluan me armë edhe në largim e sipër. Sildi Velaj u dërgua për mjekim në Tiranë, mori 4 plumba në trup. Njëjaria pas një sherri me motive të dobëta, i plagosuri po luante letra në lokal

Policia jep detaje për plagosjen në Orikum: Identifikuam dhe bashkëpunëtorin, shkaku i krimit konfliktet me motive të dobëta!



Vendi i plagosjes mbrëmë në Orikum

Armand Xhelili
27 Janar, 10:12 | **Përditësimi: 27 Janar, 12:16**

Share

A A

Vlorë- Dy persona janë shpallur në kërkim lidhur me plagosjen e ndodhur mbrëmjen e djeshme (26 Janar) në Orikum.

Policia bën me dije se kanë marrë pjesë dy persona, njëri prej tyre **Qerim Bello**, autori i ngjarjes, ndërsa personi i dytë mendohet se ka qenë drejtuesi i mjetit dhe ka ndihmuar atë të largohet nga vendi i ngjarjes.

Policia tha se ka identifikuar edhe autorin e dytë të dyshuar, i cili është **Emiljano Bello**, që rezulton kushëriri i personit që akuzohet se bëri plagosjen.

LEXO EDHE:
Atentatet në Janar, gazetarja: Makina për vrasjen e Kristian Markut sllovene, 2 kosovarë ia kishin shitur Erald Cenajt! Vështirë të gjenden prova për zhdukjen e Ervis Martinajt

Burime të grupit hetimor bëjnë me dije se ngjarja është zbardhur plotësisht dhe po punohet për arrestimin e autorëve. Shkaku i krimit dyshohet se janë konfliktet për motive të dobëta mes palëve, por ngjarja është ende nën hetim aktiv.

10 plumba pistolete u qitën në drejtim të 29-vjeçarit, ndërkohë që 4 plumba e kishin prekur Sildi Velajn, i cili u transportua mbrëmjen e djeshme në Tiranë për mjekim më të specializuar. I plagosuri në momentin e ngjarjes ka qenë duke luajtur letra në brendësi të karburantit me disa shok.

Automjet i të dyshuarve ishte tip 'Golf 5'. Autori ka hyrë në lokal dhe e ka qëlluar me armë disa herë, pastaj kanë hipur në makinë që dy për t'u arratisur.
Në momentin e largimit, një person ka dalë nga lokali dhe nga makina është qëlluar përsëri me armë nga autorët.

Rendit zhvillimet sipas orarit: 16 Fundit

Ora 12:09

Policia jep detaje për plagosjen në Orikum: Identifikuam dhe bashkëpunëtorin, shkaku i krimit konfliktet me motive të dobëta!

Momenti nga dërgimi i të plagosurit në spital

Policia e Vlorës jep detaje nga hetimet dhe dinamika e atentatit të ndodhur mbrëmjen e djeshme (26 Janar), në **Orikum**, ku mbeti i plagosur me 4 plumba Sildi Velaj.

Blutë konfirmuan identifikimin dhe shpalljen në kërkim të autorit të dytë të dyshuar si bashkëpunëtor, Emiljano Bello, 36 vjeç, teksa më herët ishte zbuluar edhe autori i dyshuar për krimin, Qerim Bello, kushëririn e tij.

Burime zyrtare bënë me dije se shkak i krimit janë "konfliktet për motive të dobëta".

Njoftimi i Policisë së Vlorës:

"*Hetime intensive për zbardhjen e plotë të rrethanave dhe dokumentimin ligjor të ngjarjes së ndodhur më datë 26.01.2025, në Orikum, ku mbeti i plagosur me armë zjarri shtetasi S. V., ndërkohë që vijon puna për kapjen e autorit të dyshuar të shpallur në kërkim.*

Në kuadër të hetimeve identifikohet dhe shpallet në kërkim një tjetër shtetas i dyshuar i përfshirë në këtë ngjarje.

Më datë 26.01.2025, rreth orës 18:40, në ambientet e lokalit të një karburanti në Orikum, dyshohet se pas një konflikti për motive të dobëta, shtetasi Q. B., 28 vjeç, ka qëlluar me armë zjarri duke plagosur shtetasin S. V, 29 vjeç, banues në Orikum. I dëmtuari është transportuar në Spitalin e Traumës në Tiranë për mjekim të specializuar.

Nga hetimet e kryera deri tani, është identifikuar dhe shpallur në kërkim edhe bashkëpunëtori i autorit të dyshuar, shtetasi E. B., 36 vjeç, banues në Orikum.

Policia po vijon intensivisht punën për kapjen e tyre, si dhe për zbardhjen dhe dokumentimin e plotë të ngjarjes. Detaje të tjera mbetenë pjesë e hetimit, që po kryhet nën drejtimin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Materialet u referuan Prokurorisë për veprime të mëtejshme".

A.Q/Shqiptarja.com

Share

A.Q/Shqiptarja.com

TAG: Vlorë orikum atentat Qerim Bello policia e vlorës Sildi Velaj Emiljano Bello

Komento

Komente

vlor: 27/01/2025 10:54
plasi lufta dhe ne orillum do filojne vrasjet seri tani

Përgjigju

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A mendoni se vota e diasporës do të jetë përcaktuese në zgjedhje?

27 Janar, 09:30

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera

Moti i keq në Vlorë, ndalohet lundrimi i anijeve të vogla lundruese dhe atyre të peshkimit për 2 ditë
27 Janar, 18:20

Vlora strehoi qindra hebrenj, Spahiu: Një pjesë e historisë së qytetit lidhet me këtë komunitet! Së shpejti do ndërtohet muzeu
Armand Xhelili
27 Janar, 15:57

Vlorë/ Goditet grupi i shpërndarësve të drogës në lokale, 2 të arrestuar! Sekuestrohen 100 doza dhe shuma lekësh (VIDEO)
27 Janar, 12:39

Policia jep detaje për plagosjen në Orikum: Identifikuam dhe bashkëpunëtorin, shkaku i krimit konfliktet me motive të dobëta!
27 Janar, 12:09

Favorizoi vjehrrin, ILD i kërkon KLP-së 2 masa disiplinore për Kledian Llahon: Largim nga detyra si kreu i Prokurorisë së Sarandës dhe ulje page!
27 Janar, 11:48

Vlorë/ Plagosje me armë zjarri pas një konflikti të gastit në Orikum! I riu në gjendje të rëndë te Trauma, autori në kërkim (EMRAT+VIDEO)
26 Janar, 19:28

Tufat e deleve po pakësohen në lumin e Vlorës! Jeta e vështirë e blegtorëve: S'kemi mbështetje, më shtrenjtë uji se gurnështi
Armand Xhelili
26 Janar, 16:31

Dyshohet se ngacmoi seksualisht një të mitur, arrestohet 71 vjeçari nga Sarandë
26 Janar, 15:00

Shisnin kokainë dhe kanabis në qytetin e Vlorës, 2 të arrestuar
26 Janar, 12:50

Vlorë/ Siguroi automjetin që u përdor në atentatin ndaj Kristian Markut, arrestohet 36-vjeçari nga Kukësi! Autorët ende në arratí
25 Janar, 14:54

Delvinë/ 38-vjeçari plagoset me thikë pas një sherri në lokal, në pranga autori (EMRAT)
25 Janar, 11:16

Primaret/ Dorëhiqet kryetarja e degës së Himarës: Sipas udhëzimit të partisë, mora vendimin të konkurrojë! Kjo, e vetmja rrugë
24 Janar, 15:14

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje